

DRAFT versioni i 25 Majit 2008

Sipas autoritetit të dhënë në Kapitullin 8 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), në sesionin publik të mbajtur më _____ miratoi:

**RREGULLËN E PROCEDURËS SË AUTORIZIMIT PËR
NDËRTIMIN E KAPACITETEVE TË REJA GJENERUESE**

**KAPITULLI 1
Kushtet e Përgjithshme**

**Neni 1
Qëllimi dhe Fushëveprimi**

- 1.1. Kjo Rregullë definon procedurën e autorizimit të projekteve për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, sipas autoritetit të dhënë ZRRE-së, e në bazë të Nenit 38.1 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë. Vet Rregulla nuk përfshin procedurën e tenderimit, që përshkruhet në Nenin 39 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë. Megjithatë, kur një kapaciteti i ri gjenerues ndërtohet si rezultat i zbatimit të procedurës tenderuese, të përputhshme me ligjin, atëherë nuk kërkohet asnjë lloj autorizimi për kapacitetin e ri gjenerues, e që është objekt i tenderit.
- 1.2. Synimi i përgjithshëm i kësaj Rregulle është të krijojë një procedurë publike, transparente dhe jo diskriminuese, e cila përkrah krijimin e një tregu konkurrues të energjisë duke nxitur investime dhe duke garantuar sigurinë dhe stabilitetin e sektorit energjetik në Kosovë.
- 1.3 Rregulla përcakton kriteret dhe procedurat e në lidhje me dhënjen e Autorizimit për ndërtim të një stabilimenti të ri gjeneruese, në mënyrë që të krijojë kushte për shfrytëzim eficient dhe kosto-efektivetë energjisë elektrike, dhe me kujdesin e duhur ndaj shëndetit njerëzor, sigurisë dhe mjedisit.
- 1.4 Asgjë në këtë Rregullë nuk do të shfuqizoj cilindo autoritet ekzistues apo cilindo institucion qeveritar ose institucion tjetër që të lëshoj leje, pëlqime apo ndonjë dokument tjetër tjetër të nevojshme për Autorizim të projektit për ndërtim të një

kapacitetit të ri gjenerues, në pajtim me mandatin dhe autoritetin e dhënë institucioneve sipas ligjeve të Kosovës.

Neni 2 Përkufizimet

- 2.1 Termat e përdorur në këtë Rregull, do të kenë kuptimin vijues:
- a) **“Aplikuesi”** është personi juridik që kërkon autorizim sipas këtij Rregulli.
 - b) **“Procedura e Autorizimit”** është procedura e përcaktuar në këtë rregull, në përputhje me Kapitullin 8 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, sipas të cilit, ZRRE-ja jep autorizime për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese.
 - c) **“Njoftimi për Vendimin Preliminar”** është njoftim i lëshuar nga ZRRE që tregon përshtatshmërinë e pritur të aplikantit për ndërtimin e stabilimentit të energjisë nëse aplikanti i plotëson kushtete e caktuara që mund të specifikojë ZRRE-ja. Çështja e Njoftimit për vendimin preliminar nuk i jep të drejtë bartësit që të vazhdojë ndërtimin e stabilimentit prodhues përderisa ai ti plotësojë të gjitha konditat e duhura dhe ti jetë lëshuar Autorizimi në përputhje me Rregullën.
 - d) **“Stabiliment Prodhimi”**– janë të gjitha ndërtesat,, instalimet dhe pajisjet të bashkuara, për të gjeneruar ngrohje, energji elektrike, ose kombinim të ngrohjes dhe energjisë elektrike, siç është ko-gjenerimi.
 - e) **“Studim i Fizibilitetit (Zbatueshmërisë)”**– nënkupton një vlerësim teknik dhe ekonomik të një projekti për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, e që kërkohet të paraqitet sëbashku me aplikacionin për Autorizim.
 - f) **“Investitor”** është çdo entitet juridik Kosovar ose i huaj, ose një asociacion i entiteteve të tilla, i angazhuar në financimin dhe ndërtimin e një njësie ose stabilimenti prodhues dhe operimin e tij, mbi baza komerciale.
 - g) **“Kapacitet Gjenerues i Rinovueshëm”**- nënkupton çdo kapacitet gjenerues që ngaset nga uji, era ose energjia diellore ose kapacitet gjenerues termike që përdorë si lëndë djegëse drurin ose ndonjë materiale tjetër bio-mase ose ndonjë teknologjit tjetër gjeneruese, e që ZRRE-ja mund ta specifikojë në cilëndo Rregullë për Gjenerimin të Rinovueshëm dhe të cilat mund t’i lëshojë kohë pas kohe.

KAPITULLI 2

AUTORIZIMI I PROJEKTIT PËR NDËRTIMIN E STABILIMENTIT TË RI GJENERUES

Neni 3 Obligimi për Autorizim

- 3.1 Siq parashihet në Nenin 38 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë , asnjë person juridik ose fizik nuk mund të ndërtojë një stabiliment prodhimi pa marrë paraprakisht një Autorizim nga ZRRE-ja në përputhje me procedurat e përcaktuara nga kjo Rregull.
- 3.2 ZRRE do ti shqyrtojë të gjitha aplikacionet për autorizim të ndërtimit të stabilimenteve gjeneruese në përputhje me këtë Rregullë dhe do të sigurojë që aplikacionet e tilla të shqyrtohen në mënyrë objektive, transparente dhe jo-diskriminuese.

Neni 4 Aplikacioni për Autorizim

- 4.1 Çdokush që aplikon për Autorizim në ZRRE-ja sipas kësaj Rregulle, duhet të sigurohet që këtë ta bëjë me shkrim dhe ne formatin e specifikuar në këtë Rregullë.
- 4.2 Të gjitha aplikacionet për Autorizim sipas kësaj Rregulle duhet të shoqërohen me taksën e aplikimit të përcaktuar nga ZRRE për një aplikacion të tillë.
- 4.3 Kur ZRRE pranon një aplikacion për Autorizim sipas kësaj Rregulle, duhet ta shqyrtojë atë në përputhje me këtë Rregull dhe mëpastaj do të:
 - a) Lëshojë një Njoftim mbi Vendimin Preliminar ose japë Autorizimin në Përputhje me kriteriumet dhe procedurat e përcaktuara nga kjo Rregull; ose
 - b) kërkojë që aplikanti të sjellë informacione shtesë nëse ZRRE e konsideron të nevojshme; ose
 - c) refuzojë lëshimin e Njoftimit mbi Vendimin Preliminarë ose japë Autorizimin në përputhje me kriteriumet dhe procedurat e përcaktuara nga kjo Rregull;

Neni 5 Obligimet dhe Kriteret për Kapacitete të Reja Gjeneruese

- 5.1. Personi që aplikon për Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese sipas kësaj Rregulle duhet të sigurojë që vet projektet, në të gjitha fazat e zhvillimit, të respektojë , të gjitha ligjet dhe rregulloret që zbatohen në Kosovë.
- 5.2. Projektet e tilla për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese duhet të sigurojnë:

- a) arritjen e një niveli të sigurisë, të harmonizuar me operimet e sistemit të energjisë në Kosovë, dhe që i nënshtrohet praktikave aktuale më të mira ligjore në lidhje me personelin, pajisjet, instalimet, makineritë dhe mbrojtjen e mjedisit;
- b) arritjen e një niveli konkurrues të performancës teknike dhe ekonomike, dhe që përputhet me zhvillimin e një tregu të liberalizuar të energjisë,;
- c) përputhje me Strategjinë e Sektorit Energjetisë të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës; duke përfshirë, përshtatjen e nevojshme, me programet dhe legjislacionin sekondar lidhur me burimet energjetike të rinovueshme dhe/ose karburantet dhe /ose teknologjitë e preferuara;
- d) pajtueshmërinë me çfarëdo obligimi publik të shërbimeve, që mund të zbatohet në çfardo projekti të veçant, dhe në pajtim me çmimin e ofruar për Furnizuesin Publik, nëse ka aplikueshmëri;
- e) disponueshmëri teknike, financiare, dhe burime njerëzore, njohuri dhe strukturë organizative për ndërtimin dhe operimin e stabilimentit;
- f) përdorimin e teknologjisë moderne përkatëse për stabilimentin përkatës dhe shfrytëzimin eficient të karburantit; furnizues primar.
- g) disponueshmëri me furnizim adekuat të karburantit primar të përdorur për gjenerimin si dhe pajtueshmëri me dispozitat për shërbimet ndihmëse;
- h) planet për hedhjen e të gjitha mbeturinave të prodhimit dhe heqjen nga përdorimi dhe/ose largimin e stabilimenteve të gjenerimit në fund të periudhës së dobishme të jetëgjatësisë në përputhje me kërkesat teknike dhe ambientale;
- i) të këtë të drejtën pronësore ose të drejta të tjera ligjore për ndërtim në një lokacionin, ashtu si është propozuar në projektin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese.

KAPITULLI 3

APLIKACIONET PËR AUTORIZIM

Neni 6

Procedura e Aplikimit

6.1 Aplikacioni për autorizim sipas kësaj Rregulle do të dorëzohet në ZRRE në formatin e specifikuar në Shtojcën 1 të kësaj Rregulle së bashku me një kopje të faturës ku tregohet se taksat e duhur është paguar në llogarinë e ZRRE-së.

6.2 Aplikacioni për autorizim sipas kësaj Rregulle duhet të shoqërohet me dokumentet vijuese, përveç kur ZRRE-ja mund të specifikojë kërkesa të thjeshtësuara për çfarëdo aplikimi sa i përket cilido kapaciteti të ri gjenerues me fuqi 5MW ose më të vogël:

- a) kopje të regjistrimit të aksioneve ose pjesëmarrjes reale të cilido nga aksionarët ose partnerët të Aplikantit, dhe kopjet e të gjitha dokumenteve të rëndësishme (marëveshjen e krijimit të shoqërisë, vendimi i gjykatës ose kopje e regjistrimit të aksionarëve, etj.) që dëshmojnë keto veçanti.;
- b) çertifikatën e regjistrimit të Aplikantit si Organizatë Afariste, që i është lëshuar nga agjencia e autorizuar për të regjistruar organizatat afariste;
- c) informacione/tregues në lidhje me situatën financiare të Aplikantit, e përgatitur në përputhje me modelin e treguar në Shtojcën 2 të këtij Rregulli, bazuar në Raportin Vjetor Financiar të Audituar për tre (3) vitet e fundit, e vërtetuar nga institucioni kompetent ose nga auditorët financiarë;
- d) Studimin e Fizibilitetit të bërë për kapacitetin e ri gjenerues të propozuar, duke përfshirë disponueshmërinë e karburantit dhe me elemente të tjera si në Shtojcën 3;
- e) dëshmi të aftësisë teknike, financiare si dhe përvojën e aplikantit për të ndërtuar, poseduar ose drejtuar projekte gjeneruese të një madhësie dhe kompleksiteti të specifikuar në Aneksin 3;
- f) çertifikatën që aplikanti nuk është në situatë falimentimi, që biznesi i tij nuk administrohet nga gjyqtari, që aktivitetet e tij komerciale nuk janë pezulluar, ose që nuk ndodhet në asnjë situatë tjetër të ngjashme dhe/ose që përndryshe mund të konsiderohet si shkelje ligjore
- g) çertifikatën se Aplikanti përmbush detyrimet lidhur me pagimin e taksave në vendin ku është regjistruar si entitet juridik, dhe se i ka paguar ato rregullisht;
- h) informacione në lidhje me menaxhimin dhe strukturën organizative të Aplikantit. sipas kërkesave në Aneksin 3;
- i) Biografite (CV-të) e stafit menaxhues të Aplikantit dhe një listë të stafit tjetër të lartë së bashku me kualifikimet e tyre sipas kërkesave në Aneksin 3.

6.3 Nëse Aplikanti vepron në emër të një “Kompanie Aksionare”, “Konzorciumi”, ose ndonjë lloji tjetër shoqërie, kualifikueshmëria e investitorit do të vlerësohet bazuar në informacionin, përfshirë atë financiar, që ka të bëjë me çdo anëtar të asociacionit, dhe që i dërgohet ZRRE-së nga përfaqësuesi i vet ligjor.

6.4 Pas marrjes së aplikacionit, ZRRE-ja do ta regjistroj atë në regjistrin e aplikacioneve.

- 6.5 ZRRE-ja do të sigurojë që aplikacioni dhe të gjithë dokumentet e bashkangjitura dhe informacionet tjera të regjistrohen, arkivohen dhe të vihen në dispozicion publik në zyrën e ZRRE-së.
- 6.6 Në konsultim me Aplikantin, ZRRE-ja mund të vendosë se cilat të dhëna ose dokumente do të konsiderohen konfidenciale, në përputhje me Rregullën mbi Informatat Konfidenciale, dhe dokumentet e tilla nuk do bëhet publike.

Neni 7 Taksat për aplikim

- 7.1 Të gjithë Aplikantët për Autorizim sipas kësaj Rregulle do t'i paguajnë ZRRE-së taksën për shpenzimet e veta administrative, në shumën e specifikuar me Vendimin e ZRRE-së nxjerrë kohë pas kohe nga Bordi i ZRRE-së. Aplikanti do të paguajë veçmas taksën e licencimit për vënien në funksion të stabilimentit të ri, siç kërkohet nga Pasqyra e Taksave.
- 7.2 Çdo ndihmë administrative shtesë që kërkohet nga Aplikanti prej ZRRE-së, si janë psh. kopjet shtesë të dokumenteve, do t'i ngarkohet financiarisht Aplikantit në varësi me shpenzimet e bëra për këtë ndihme.
- 7.3. Aplikanti duhet të sjellë një kopje të faturës së taksave të paguara për aplikacionin për Autorizim, brenda pesë (5) ditëve të punës pas dorëzimit të aplikacionit për autorizim.
- 7.4. Pagesa nuk është e kompensueshme edhe në rast se autorizimi nuk jepet.

Neni 8 Gjuha dhe Regjistrimi i Aplikacioneve

- 8.1. Aplikacioni do të dorëzohet në një origjinal dhe gjashtë (6) kopje të vërtetuara. Aplikacioni do të dorëzohet në kopje të shtypur dhe në formë elektronike.
- 8.2. Aplikacioni do të dorëzohet në një nga gjuhët: Shqip, Serbisht, ose në Anglisht. .
- 8.3 Në rast të ndonjë dokumenti të nxjerrë në ndonjë gjuhë tjetër përveç Shqipes, Anglishtes ose Serbishtes, Aplikanti duhet të dorëzojë përkthimin në një nga gjuhët zyrtare, të vërtetuar nga Notari gjyqësor **i regjistruar në Kosovë.**

Neni 9 Publikimi i Aplikacioneve

- 9.1. Brenda dy (2) javësh pas dorëzimit të aplikacionit në ZRRE sipas Nenit 5.1, Aplikanti do ti publikojë në dy (2) gazeta ditore me qarkullim të gjerë në Kosovë:

- a) një përmbledhje të shkurtër të përmbajtjes së aplikacionit;
 - b) një njoftim se një kundërshtim i aplikacionit ose shprehjes së interesit për pjesëmarrje në rishikim nga palët e treta mund ti bëhet ke ZRRE-së brenda dy (2) javësh prej datës në të cilën ZRRE-ja konsideron se aplikacioni është i kompletuar,
- 9.2. Kur ZRRE pranon një aplikacion për Autorizim, duhet ta publikojë në dy (2) gazeta ditore me qarkullim të gjerë në Kosovë:
- a) një përmbledhje të shkurtër të aplikacioneve të pranuar;
 - b) përshkrimin e çfarëdo procesi në të cilin palët e treta mund të kundërshtojnë një aplikacion.
- 9.3 Nëse ZRRE-ja ka marrë ndonjë kundërshtim për aplikacionin, do t'ia paraqesë një kopje të tij Aplikantit dhe do ta botojë në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
- 9.4 Aplikanti dhe/ose ZRRE-ja nuk do të zbulojnë asnjë informacion që klasifikohet si konfidencial, në përputhje me Rregullin mbi Informatat Konfidenciale.

Neni 10

Dhënja e Informacioneve të Mëtejshme

- 10.1 Në rast se ZRRE vlerëson se i duhen më shumë informacione ose sqarime nga një aplikant, atëherë vet ZRRE-ja duhet t'ia bëjë një kërkesë të tillë aplikantit për informacione dhe të dhëna shtesë jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e pranimit dhe regjistrimit të aplikacionit,
- 10.2 Njoftimi mbi kërkesën e Aplikantit për sqarim ose informacion dhe të dhëna shtesë, do të përmbajë afatin përfundimtar prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditë brenda të cilit Aplikanti do të dorëzojë përgjigjen e tij. ZRRE-ja mund të shtyjë afatin përfundimtar në rast se Aplikanti tregon arsyetim të bindshëm për mosarritjen e përmbushjes së afatit përfundimtar.
- 10.3 Nëse Aplikanti vonon pa arsye bindëse përgjigjen e kërkuar, ZRRE-ja ka të drejtën të refuzojë aplikacionin pa njoftim paraprak dhe pa kompensuar asnjë pagesë, ose të vendosë mbi aplikacionin, bazuar në dokumentet dhe informacionet ekzistuese, dhe të njoftojë Aplikantin për vendimin e vet.
- 10.4 Pas përcaktimit se aplikacioni nuk kërkon sqarim ose informacione dhe të dhëna shtesë, ZRRE-ja do të njoftojë aplikantin se aplikacioni është konsideruar si i mjaftueshëm.

- 10.5 Pavarësisht nga dispozitat e tjera të kësaj Rregulle, ZRRE-ja mban të drejtën të kërkojë informacione dhe të dhëna shtesë nga Aplikanti, në çdo kohë gjatë procedurës së autorizimit..

KAPITULLI 4

VENDIMET MBI APLIKACIONET PËR AUTORIZIM

Neni 11

Vendimet e ZRRE-së mbi Aplikacionet për autorizim

- 11.1 ZRRE-ja do të marrë një vendim formal për secilin aplikacion brenda [3] muajsh nga data kur ZRRE-ja ka njoftuar Aplikantin se aplikacioni konsiderohet i kënaqshëm sipas kushteve të Nenit 10.4, por nëse ZRRE-ja e konsideron të nevojshme, atëherë mund të përcaktojë zgjatjen e shqyrtimit të aplikacionit për një periudhë që zgjatë deri në 2 muaj.
- 11.2 Nëse ZRRE përcakton se aplikanti i ka përmbush ose pritet ti përmbushë të gjitha kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregull dhe në Ligjin e Rregullatorit për Energji, ZRRE-ja do të:
- a) lëshojë Njoftimin mbi vendimin preliminar në përputhje me Nenin 12 që konfirmon se Aplikantit do ti jepet një Autorizimi në bazë të disa kushteve të caktuara që duhet të përmbushen brenda periudhës së specifikuar kohore; ose
 - b) japë një Autorizim sipas Nenit 14, për ndërtim të stabilimentit prodhues që ka qenë lëndë e aplikacionit, kur ZRRE është e bindur se janë plotësuar të gjitha kushtet tjera të nevojshme dhe se mund të lëshohet autorizimi.
- 11.2 Çdo vendim i ZRRE-së se Autorizimi ose Njoftimit mbi Vendimin Preliminar do ti lëshohet Aplikantit, sipas kësaj Rregulle, do të publikohet nga ZRRE-ja në të njëjtën mënyrë si botohen detajet e aplikacionit sipas Nenit 9.2.

Neni 12

Lëshimi i Njoftimit mbi Vendimin Preliminar

Pasi ZRRE-ja ka përcaktuar se Aplikanti ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e stabilimentit Prodhues, porse nuk ka plotësuar ende kërkesat tjera që dalin nga legjislacioni tjetër i aplikueshëm lidhur me stabilimentet gjeneruese, ZRRE mund të lëshojë Njoftimin e vendimit preliminar. Një Njoftim i tillë i vendimit preliminar do të konfirmojë se Aplikantit do ti jepet një autorizim nëse; jo me vonë se **dy (2)** vite pas datës së lëshimit të Njoftimit mbi vendimin preliminar, Aplikanti do të:

- a) bëjë një aplikim të mëtejshëm në ZRRE duke kërkuar që ti lëshohet Autorizimi;

- b) dorëzojë ZRRE-së të gjitha dëshmitë dokumentuese të nevojshme që ZRRE mund ti kërkojë në mënyrë që bindet se të gjitha kërkesat relevant legjislative tanimë janë plotësuar;
- c) përmbushë çfarëdo kondite tjetër të përcaktuar në Njoftimin e Vendimit preliminar, dhe
- d) paguajë ZRRE-së taksën relevante shtesë si do specifikohet në Vendimin e ZRRE-së mbi taksat.

Neni 13

Aplikacionet për shndërrimin e Njoftimit mbi Vendimin Preliminar në Autorizim

13.1 Çdo aplikacion nga bartësi i Njoftimit për Vendim preliminar për lëshimin e një autorizimi lidhur me ndërtimin e stabilimentit gjenerues duhet të shoqërohet nga dokumentacioni vijues:

- a) çfarëdo dokumenti që detajizon çfarëdo ndryshimi që duhet të azhurohet, ose finalizimin e dokumentacionit të specifikuar në Nenin 6.2, që janë dorëzuar ose do të duhej të ishin dorëzuar së bashku me aplikacionin kur është dhënë Njoftimi mbi Vendimin Preliminar, nëse nuk do të kërkohet nga aplikanti për të ri-dorëzuar çfarëdo dokumenti që tanimë është paraqitur përveç nëse rrethanat materiale kanë ndryshuar që nga lëshimi i Njoftimit të Vendimit Preliminar;
- b) dokumentacion dëshmi nga autoritetet relevante se Aplikanti i ka përmbushur të gjitha kërkesat mjedisore dhe ato statusore sipas legjislacionit relevant në Kosovë, përfshirë këtu edhe të drejtave të duhura mbi ujin aty ku aplikohen.

13.2 Pas marrjes së aplikacionit, ZRRE-ja duhet :

- a) regjistrojë atë në regjistrin e aplikacioneve;
- b) sigurohet që aplikacioni dhe të gjitha dokumentet shoqëruese si dhe informatat tjera janë regjistruar, arkivuar dhe janë në dispozicion publik në zyrën e ZRRE-së;
- c) në konsultim me Aplikantin, vendosë cilat specifika ose dokumente konsiderohen konfidenciale në përputhje me Rregullën mbi Konfidencialitetin e Informatave dhe dokumentet e tilla nuk do të jenë të disponueshme për publikun; dhe
- d) publikojë atë ashtu si specifikohet në Nenin 9.

13.3 Pas përcaktimit se nuk kërkohet asnjë qartësim ose informacion dhe të dhëna shtesë, ZRRE-ja do të njoftojë Aplikantin se aplikacioni vlerësohet i mjaftueshëm.

13.4 Pa marrë parasysh dispozitat e tjera të kësaj Rregulle, ZRRE-ja rezervon të drejtën që të kërkojë informata dhe të dhëna shtesë nga aplikanti në çfarëdo kohe gjatë procedurës së autorizimit.

Neni 14

Dhënia e Autorizimit

- 14.1 ZRRE-ja do të marrë vendim formal për secilin aplikacion brenda [3] muajve që nga data në të cilën ZRRE-ja ka njoftuar Aplikantin se aplikacioni është vlerësuar i mjaftueshëm sipas konditave të nenit 13.3, përveç atëherë kur ZRRE-ja e konsideron të nevojshme që të përcaktojë se periudha e shqyrtimit të aplikacionit mund të shtyhet për një periudhë që mund të zgjasë më së shumti 2 muaj.
- 14.2 Nëse ZRRE përcakton se Aplikanti i ka plotësuar të gjitha kërkesat e duhura dhe kriteriumet e saj sipas Rregullës mbi dhënien e Autorizimit, ZRRE do të japë Autorizimin mbi ndërtimin e stabilimentit prodhues që ka qenë lëndë e aplikacionit.
- 14.3 Çdo vendim i ZRRE-së mbi dhënien e Autorizimit Aplikantit sipas kësaj Rregulle duhet të publikohet ashtu si përcaktohet me nenin 11, dhe duhet të përmbajë që:
- a) aplikanti ti plotësojë dhe vazhdojë ti plotësojë të gjitha kërkesat mjedisore dhe kërkesat tjera ligjore sipas legjislacionit relevant në Kosovë;
 - b) të modifikojë ose revokojë në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulle; dhe
 - c) një zotim nga ZRRE që nëse të gjitha konditat relevant të Autorizimit janë plotësuar, ti lëshojë një licencë prodhimi të energjisë elektrike aplikantit pas përfundimit të stabilimentit prodhues.

Neni 15

Refuzimi për dhënien e Autorizimit

- 15.1 Nëse ZRRE vlerëson se Aplikanti nuk i ka plotësuar kërkesat ose kushtet e përcaktuara nga kjo Rregullë, atëherë ZRRE mund ta refuzojë dhënien e Njoftimit mbi Vendimit Preliminar ose Autorizim për ndërtim të stabilimentit prodhues.
- 15.2 Çdo vendim i ZRRE-së për refuzim të Njoftimit mbi Vendimit Preliminar ose Autorizimit sipas kësaj Rregulle duhet:
- a) ti dorëzohet aplikantit me shkrim përfshirë edhe arsyet e refuzimit; dhe
 - b) të publikohet në faqen elektronike të ZRRE-së.

KAPITULLI 5

AUTORIZIMI DHE APLIKACIONI PËR LICENCË

Neni 16

Aplikacioni për Licencë

- 16.1. Pas dorëzimit të aplikacionit për Autorizim sipas kësaj Rregulle, ose në çdo moment të më pastajmë, Aplikanti gjithashtu mund ti dorëzojë ZRRE-së edhe aplikacionin për licencë të stabilimentit prodhues në përputhje me kërkesat që dalin nga Rregulla për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
- 16.2. ZRRE-ja shqyrton aplikacionet e tilla dhe dokumentet e dorëzuara, dhe marr në konsideratë çështjen e dhënies së licencës për operim, në përputhje me Rregullën mbi Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, brenda afatit të përcaktuar me Rregullin mbi Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
- 16.3 Nëse ZRRE përcakton se licenca mund të jepet, ose në rrethana pas përfundimit të stabilimentit që mund të ekzistojnë për tu dhënë licenca, atëherë ajo do të lëshojë licencën ose njoftojë aplikantin përputhshmërisht. Një licencë ose njoftim i tillë duhet të specifikojë ato kushte që mund të jenë të nevojshme për tu plotësuar pas përfundimit të ndërtimit të stabilimentit prodhues në mënyrë që të sigurohet se licenca do të vazhdojë të jetë e vlefshme, ose do të lëshohet.
- 16.4. Nëse ZRRE-ja përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për dhënien e licencës dhe se nuk ekziston indikacion që ato të plotësohen, atëherë do të njoftojë aplikantin për refuzimin e lëshimit të licencës, cilat kushte nuk ka arritur të plotësojë aplikanti si dhe për masat që duhet të ndërmerret ai për të plotësuar kushtet.

KAPITULLI 6

MODIFIKIMI I AUTORIZIMIT

Neni 17 Modifikimi

- 17.1. Modifikimi i Autorizimit mund të inicohet prej ZRRE-së ose me kërkesën e mbajtësit të Autorizimit.
- 17.2. Kushtet e Autorizimit për Ndërtimin e Stabilimentit të Ri Prodhues mund të modifikohen me anë të vendimit të ZRRE-së, në mënyrën e specifikuar në Rregullin mbi Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
- 17.3. Modifikimi nuk mund të aplikohet në mënyrë retroaktive në Autorizim.

Neni 18 Njoftimi për Modifikim

- 18.1. Njoftimi për qëllimin e fillimit të modifikimit të një autorizimi, do të botohet në faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së. Njoftimi gjithashtu do të publikohet në dy (2) gazeta ditore të qarkullimit të gjerë brenda Kosovës:

- a) nga ZRRE-ja në rast se kjo fillon modifikimin, ose
- b) nga mbajtësi i Autorizimit, nëse ai ka kërkuar modifikimin.

18.2. Publikimi duhet të përfshijë:

- a) arsyet për fillimin e modifikimit
- b) vlerësimin e efekteve të mundshme
- c) afatin përfundimtar që do të jetë jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarikë nga data e publikimit të njoftimit brenda të cilit mund të dërgohen kundërshtimet me arsytetime.

18.3. Nëse ZRRE-ja e sheh të domosdoshme, ajo mund ta zgjasë afatin përfundimtar për paraqitjen e kundërshtimeve.

Neni 19 **Vendimet për Modifikim**

19.1. Për të vendosur mbi modifikimin e një Autorizimi, ZRRE-ja do të marrë parasysh:

- a) arsyetimet e dhënë nga mbajtësi i Autorizimit;
- b) vërejtjet e dorëzuara nga palët e tjera;
- c) çdo informacion tjetër që konsiderohet si i nevojshëm;
- d) konsistenca e modifikimit duhet të përputhet me kriteret në bazë të të cilave është bërë dhënia e autorizimit.

19.2. ZRRE-ja do të publikojë vendimin e vet dhe arsyetimin për vendimet në përputhje me ligjin dhe rregullat e aplikueshme që janë miratuar nga ZRRE-ja.

Neni 20 **Revokimi i Autorizimit**

20.1. Një Autorizim mund të revokohet në përputhje me afatet dhe kushtet e tij.

20.2. ZRRE-ja mund të heqë/shfuqizojë Autorizimin në rast se:

- a) mbajtësi i Autorizimit bën shkelje të Ligjit, kësaj Rregulle ose çdo kondite, kushti ose kufizimi të përfshirë në Autorizim; ose
- b) dhënia e Autorizimi është bazuar në informacione materialisht të rreme ose të gabuara;
- c) skadimi i periudhës së vlefshmërisë së Autorizimit ndodh para se të finalizohet stabilimenti prodhues;
- d) me kërkesë të mbajtësit të Autorizimit;
- e) shpërbërjen e personit ligjor që mban Autorizimin;

- f) nëse gjykata ka marrë një vendim ku deklarohej paaftësia për të paguar nga ana e mbajtësit të Autorizimit ose përfundimi i aktivitetit të mbajtësit të autorizimit;
- g) mos pagesa e gjobës ose dënimit të caktuar nga ZRRE-ja për mos përmbushje të kushteve të Autorizimit, siç është përcaktuar në Nenin 21 të kësaj Rregulle.

Neni 21

Ndëshkimet e vendosura nga ZRRE-ja

- 21.1. Kur cilido person fillon ndërtimin e një stabilimenti të ri gjenerues pa pasur Autorizim të vlefshëm për atë stabiliment të dhënë në përputhje me këtë Rregull, ai person mund të gjobitet nga ZRRE-ja sipas Nenit 57 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë ose bazuar në Rregullën mbi Masat Administrative dhe Gjobat e lëshuar nga ZRRE-ja.
- 21.2. Kur vendos gjobën sipas këtij Kapitulli, ZRRE-ja do të njoftojë personin për shkeljen dhe do t'i japë një mundësi për t'u përgjigjur me shkrim, brenda katërmëdhjetë (14) ditësh kalendarik nga data e njoftimit.
- 21.3. Nëse gjoba e vendosur nga ZRRE-ja nuk paguhet, atëherë ZRRE do të fillojë procedurat gjyqësore për mbledhjen e gjobës si borxh civil.
- 21.4. Nëse mbajtësi i Autorizimit nuk arrin të përmbush kushtet e përcaktuara në Autorizim apo nuk përmbush ndonjë nga kërkesat e përcaktuara me këtë Rregull, ZRRE mund të **shfuqizoj** Autorizimin ose refuzoj dhënien e licencës për operim të stabilimentit të ri gjenerues për të cilin është lëshuar Autorizimi. Shfuqizimi i Autorizimit dhe refuzimi i dhënies së Licencës janë sanksione serioze dhe duhet të aplikohet vetëm pasi që bartësit të Autorizimit i është dhënë mundësia për të korrigjuar shkeljen.

Neni 22

Ankesa ndaj Vendimit të ZRRE-së

- 22.1. Vendimi i ZRRE-së për të dhënë ose për të rrefuzuar dhënien e një autorizimi, mund të kontestohet nga palët e interesuara brenda tridhjetë (30) ditësh pune prej datës së botimit të vendimit.
- 22.2. Përgjigja e ZRRE-së në ankesë do t'i dërgohet palës kontestuese, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh kalendarik prej datës së pranimit dhe regjistrimit të ankesës.
- 22.3. Nëse përgjigja e ZRRE-së është e papranueshme për palën kontestuese, pala mund të ankohet në vendimin në Gjykatën kompetente.

Kapitulli 7

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 23

Ndryshimi ose Modifikimi i Rregullit

- 23.1. Çdo propozim për ndryshim ose modifikim të këtij Rregulli do t'i dërgohet ZRRE-së me shkrim, ose do të inicohet nga vetë ZRRE-ja.
- 23.2. Ndryshimi ose modifikimi do të bëhen nga Bordi i ZRRE-së, vetëm nëse është i nevojshëm për shtyrje të mëtejshëm të objektivave të ZRRE-së dhe është në interesin të përgjithshëm.
- 23.3. Vendimi do të botohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, dhe nëse është e mundur, edhe në gazetën ditore, televizione dhe radio, të paktën tridhjetë (30) ditë kalendarik përpara hyrjes në fuqi.

Neni 24

Gjuha Zyrtare e Rregullit

Kjo Rregulle është nxjerrë në një të njëzën në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje në lidhje me termat, dhe në rast se mosmarrëveshje rrjedh prej përkthimeve të ndryshme të kësaj Rregulle, do të mbizotërojë versioni në gjuhën angleze.

Neni 25

Hyrja në Fuqi dhe Vënia në Aplikim

Ky Rregull do të hyjë në fuqi tridhjetë (30) ditë kalendarike pas aprovimit nga Bordi i ZRRE-së dhe pas botimit të tij në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Kryesuesi i Bordit të ZRRE-së:

Anëtarët e Bordit:

SHTOJCA Nr. 2
Deklarata financiare (model)

Ne konfirmojmë:

.....
(Emri, Institucioni, Nënshkrimi i
Autorizuar, Vula)

Treguesit Financiarë

Aplikanti
(Emri i entitetit juridik)

A. Treguesit Financiarë:

Treguesit e llogaritur në përputhje me

Nr.	Treguesi	nga raportet vjetore			
		viti	viti -1	viti -2	viti -3

1. Hersi (Ratio) aktual %
2. Përqindja e aftësisë së pagimit %
3. Margjina e profitit %
4. Qarkullimi i kapitalit punues

1. "Hersi" aktuale % = asetet aktuale/borxhet aktuale \times 100 (%), prej të cilave:

- asetet aktuale = rezervat e kompanisë + pasuri të tjera qarkulluese;
- borxhet aktuale (brenda një viti fiskal) = furnizuesit dhe llogari të tjera të ngjashme + huat afatshkurta + rrogat dhe pagesat + taksa dhe detyrime.

2. Raporti i Aftësisë së pagimit = ekuitet /detyrimet totale, më pak konsumatorë kreditorë të vegjël dhe llogari aktuale, dhe të tjera si këto \times 100 (%)

3. Teprica e përfitimit = përfitim bruto ose humbje për vitin financiar /qarkullimi \times 100 (%)

B. Treguesit për kapacitetin financiar të Aplikantit, prej (data)

1. ASETET TOTALE (mijëra €), prej të cilave:

1.1. Asetet aktuale - TOTAL (mijëra €)

2. Detyrimet - TOTAL (mijëra €), prej të cilave:
 - 2.1. Borxhet - TOTALI (mijëra €)
 - 2.1.1. Borxhet që duhen paguar brenda një viti (mijëra €),
3. Kapitali punues (pika 1.1 - pika 2.1.1) - TOTAL (mijëra €)
4. Akumulime Bankare - TOTAL (mijëra €).....
5. Kreditë aktuale - TOTAL (mijëra €)
6. Kredi të tjera (të pa konsumuara ende) - TOTAL (mijëra €)
7. Të ardhurat (prej veprimtarive) - TOTAL (mijëra €)

Menaxheri Financiar,

Menaxheri i përgjithshëm,

.....

.....

(Emri dhe nënshkrimi)

(Emri dhe nënshkrimi, Vula)

1.1.1.1 SHËNIM:

Investitorët e huaj mund të paraqesin situatën financiare për kompaninë e përbashkët në Kosovë të lidhur me “kompaninë–prind” prej jashtë, për aq kohë sa të gjithë përkushtimet e veta financiare kanë qenë supozuar në mënyrë të pakushtëzuar. Informacioni duhet të paraqitet në shqip/serbisht dhe anglisht. ZRRE-ja mundet të shqyrtojë edhe informacione tjera në lidhje me *Besueshmërinë financiare të stabilimentit të ri gjenerues të propozuar*.

SHTOJCA Nr. 3

PYETËSOR

Udhëzime për plotësim

- 1) Aplikuesi duhet të plotësojë çdo seksion të këtij **PYETËSORI** dhe të bashkangjes gjithë dokumentet justifikuese, përpara se t'ia paraqesë ZRRE-së, së bashku me kërkesën, në përputhje me këtë Rregull.
- 2) Çdo dokument i bashkangjitur në këtë **PYETËSOR** duhet të shënohet qartë me një tregues në lidhje me seksionin/Pyetjen shoqëruese.
- 3) **PYETËSORI** duhet nënshkruar nga aplikuesi ose përfaqësuesi ligjor i autorizuar i aplikuesit, dhe duhet të shoqërohet nga një dokument ku dëshmohen kompetencat e këtij personi.

Seksioni I: Kriteret financiare

Nr. crt. (nr.)	Pyetje	Dokumentet e rekomanduar
1.	Emri i Investitorit ose Emri i çdo anëtar të Investitorit, konzorciumit, në rast të një shoqate apo partneriteti.	- Certifikata e Regjistrimit të Aplikantit si një kompani afariste. - Kontrata/Statuti i Shoqatës.
2.	Përfaqësuesi ligjor i autorizuar i Aplikuesit, adresa, telefoni dhe fakti, adresa e e-mail.	Vendimi i Bordit të Administratës ose ndonjë dokument tjetër që dëshmon kompetencat e personit.
3.	Deklaroni rolin e secilit anëtar të Partneritetit në lidhje me: 21. Marrëveshjet financiare, 22. Ekzekutimin e kontratës/ave Inxhinierike, të Prokurimit dhe Ndërtimit (IPN). Në rast se anëtarët e Partneritetit nuk sigurojnë dot të gjitha shërbimet kryesore për Projektin, ju lutemi emëroni furnitorët e propozuar (p.sh. Teknologjitë, etj.), por jo më shumë se 5 për çdo pikë.	
4.	Ju lutemi përshkruani përvojën e Aplikuesit/anëtarëve (identifikuar në #3), dhe këshilltarëve të tyre (nëse është e nevojshme), në marrjen e financave për projektet e centraleve të energjisë.	Lista e projekteve referencë
5.	Ju lutemi, përshkruani se si propozon Aplikuesi të financojë projektin.	Bashkangjisni letrat e synimit të një Huadhënësi të mundshëm

Nr. crt. (nr.)	Pyetje	Dokumentet e rekomanduar
6.	Ju lutemi, specifikoni ndonjë finansim alternativ që mund të ekzistojë për stabilimentin e ri gjenerues të propozuar.	Bashkangjitni letrat e synimit të një Huadhënësi të mundshëm
7.	Klasifikimi i kreditit të Aplikuesit ose Partnerëve	Ju lutemi deklaroni përqindjen e kreditit, llojin dhe nivelin, emrin e Agjencisë Tatimore, si dhe ngjisni dokumentacionin shtesë për të gjithë siguresit e ekuiteteve.
8.	Ju lutemi konfirmoni dhe siguroni prova mbështetëse që Aplikuesi dhe/ose anëtarët, janë entitete të krijuar si duhet, sipas ligjeve në vendin ku janë themeluar.	Korrelacion me #1
9.	Informacione Financiare.	Ju lutemi siguroni treguesit financiarë, të llogaritur për 3 vjetët e fundit, në përputhje me modelin e treguar në Shtojcën 2 të Rregullit, çertifikuar nga një institucion fiskal.

Seksioni II: Kërkesat Teknike dhe Organizative

Nr. crt. (nr.)	Pyetje	Dokumentet e rekomanduar
10.	Ju lutemi siguroni Skemën e propozuar Organizative të Aplikuesit për realizimin e stabilimentit të ri gjenerues të propozuar.	
11.	Ju lutemi siguroni emrin e përfaqësuesit të përcaktuar nga Aplikanti.	Ju lutemi siguroni biografine(CV) ose kriteret minimale në lidhje me kualifikimin e tyre dhe përvojën përkatëse.
12.	Ju lutemi siguroni emrin e menaxherëve të të projektit të emëruar nga Aplikuesi për projektin.	Ju lutemi siguroni CV ose kërkesa minimale në lidhje me kualifikimin e tyre dhe përvojën përkatëse.
13.	Ju lutemi siguroni referenca në lidhje me përvojën e Aplikantit/ëve, në projekte të ngjashme: a) Realizuar nga Aplikanti si Investitor b) ku Aplikanti është përfshirë në kontrata afatgjata për shitjen e energjisë.	Ju lutemi siguroni referenca ku specifikohet vendndodhja, data e fillimit dhe data e përfundimit të projektit.
14.	Ju lutemi siguroni emrin e Konsulentëve për Inxhinieri, dhe deklaroni fushat për të cilat janë zgjedhur.	-Marrëveshja/Kontrata/ Letra e Synimit/Ftesa për Tender/ Specifikimet Teknike -Ju lutemi siguroni referenca ose kriteret në

Nr. crt. (nr.)	Pyetje	Dokumentet e rekomanduara
		lidhje me përvojën e Konsulentëve
15.	Ju lutemi siguroni emrin e Kontraktuesit të emëruar IPN (individ, kompani ose JV/konzorcium me anëtarë të shumëfishtë), dhe identifikoni Kontraktuesin kryesor IPN, ose nëse nuk është emëruar ende, specifikoni mënyrën dhe kriteret për përzgjedhje.	<ul style="list-style-type: none"> - Marrëveshja/Kontrata/ Letra e Synimit/Ftesa për Tender/ Specifikimet Teknike - Ju lutemi siguroni referenca ose kritere në lidhje me përvojën e Kontraktuesve në projekte të ngjashëm
16.	Ju lutemi siguroni detaje të kriterëve për përvojën e Menaxherit të Projektit të Kontraktuesit IPN.	<ul style="list-style-type: none"> - përshkrimi i pozitës - CV (Curriculum Vitae)
17.	Ju lutemi siguroni planin afarist për funksionimin komercial të stabilimentit prodhues	- Planin e Funksionimit dhe Mirëmbajtjes së Biznesit.
18.	Cilave organizata ose persona Aplikanti propozon që tu shitet energjia elektrike ose shërbimet tjera që do të ofrohen nga stabilimenti gjenerues, dhe në çfarë kushte?	-Përmbledhja e çfarëdo kontrate aktuale apo të propozuar në lidhje me energjinë dalëse të stabilimentit, identifikimin e çmimeve, sasisë, dhe homologët e kontratës.
19.	Përshkruani planin për kyçjen në rrjetin e bartjes ose të shpërndarjes së energjisë elektrike/ngrohjes.	<ul style="list-style-type: none"> - Ju lutem precizoni qëllimin e punës për kyçje në rrjet. -puna që do të bëhet në vendin e kyçjes - puna që do të bëhet për të shtyrë/ose zmadhuar linjat e rrjetit elektrik për shkak të realizimit të kyçjes ose alterimit;
20.	Përvetësimi i tokës.	Ju lutemi siguroni informacione në lidhje me gjendjen ligjore të tokës që do të përdoret për vendndodhjen e Stabilimentit Prodhuar, dhe rrethinën, (në pronësi të tjerëve), dhe aktivitetet e tjera që do të kufizohen nga vendndodhja e Stabilimentit Prodhuar.
21.	Kërkesat mjedisore	Ju lutemi që të paraqitni dëshmi dokumentuese që konfirmojnë se Stabilimenti gjenerues i planifikuar që të ndërtohet , do të jetë në pajtueshmëri me Ligjet mjedisore në Kosovë dhe legjislacionin sekondar të lëshuar nga Ministria relevante, dhe që Ministria relevante të konfirmojë pajtueshmërinë me këtë legjislacion.

22.	Kërkesat tjera relevante legjislative, përfshirë edhe të drejtat mbi ujin.	Ju lutemi të paraqitni dëshmi dokumentuese nga autoritetet relevante që konfirmojnë se Aplikanti i ka plotësuar të gjitha kërkesat e aplikueshme statusore sipas legjislacionit relevant në Kosovë përfshirë edhe të drejtat mbi ujin aty ku aplikohen.

Seksioni III: Parametrat Financiarë

Nr. crt. (nr.)	Pyetje	Dokumentet e rekomanduar
23.	Vlera e Investimit (€).	Vlerësimet e Kostos Kapitale
24.	Kohëzgjatja e periudhës së ndërtimit dhe përqindja vjetore e vlerës së Investimit.	
25.	Burimet financiare (kapitali vetjak, huatë), plani financues: plani i përdorimit të fondeve dhe pagesës (në lidhje me planin e ekzekutimit), afatet e kthimit të huave dhe kostove financiare të shoqëruara (normat e interesit, taksat, tatimet dhe të tjera).	Burimet e deklaruara të financimit ose dokumente të tjera që kanë të bëjnë me to.
26.	Stabilimenti prodhues.	Përmendni vlerat e garantuara që priten për: <ul style="list-style-type: none"> - Energjinë Elektrike të Instaluar (MW) - Energjinë Elektrike Neto (MW) - Disponueshmëria e Njësive (%) - Faktori i kapacitetit të stabilimentit (%) - Parashikimi i shitjeve vjetore të energjisë elektrike dhe ngrohjes - Kopjet e çfarëdo studimi të fizibilitetit teknik apo komercial të bëra për projektin.